

Esselamu alejkum vëllezër dhe motra në fe. Kjo është një tregim që më ka ndodhur mua personalisht. Para tre javëve më erdhi një e-mail, të cilin ma kishte dërguar një vajzë, e cila jetonte në Australi. Mes tjerave në e-mail qëndronte edhe kjo: "Jam një vajzë libaneze, nga një babë musliman dhe një nënë e krishterë. Kam jetuar në Liban dhjetë vitet e para, e pastaj kemi migruar me babain dhe nënën time në Australi që të ndërpritet lidhja ime tërësisht me lindjen e mesme që nga kjo datë. Tani kam 22 vjet. Me udhëtimin tim atje kam ndërprerë të gjitha kontaktet me fenë time. Tërë atë që di mbi fenë është vetëdija se unë jam muslimane, nuk e di formën e mus'hafit, nuk e di as Fatihanë, nuk di si të falem, kurse feja nuk paraqet asgjë në jetën time. Pastaj u nda babi nga nëna ime dhe secili prej tyre u martua me tjetërkënd, gjersa unë hyra në universitet. Që të dytë e lanë Australinë dhe më lanë mua të vetmuar, pa familje dhe pa vëllezër. Nuk di asgjë për gjyshërit e mi që jetojnë në Liban. Kam jetuar e vetmuar. Më është imponuar që të punojë për të shpenzuar për vetevten. Në mëngjes studioja në universitet, kurse në mbrëmje punoja në bar. Kisha edhe dashnor (boy friend), në kuptimin perëndimor të fjalisë. Nuk kam lërë gjë të ndaluar pa e bërë, pa turp dhe pa dhimbje. Jam bërë tërësisht perendimore. Gjuhën arabe e di dobët.

Pasiqë isha shumë e bukur, mora pjesë në mis të bukurisë të Zelandës së Re dhe fitova vendin e parë në qytetin ku u mbajt kjo garë. Tani përgatitem të hyjë në gara për mis të Zelandës. U bëra fotodomel e gazetave imorale. Ndërkohë vizitoja një familje libaneze që jetonin në Australi. Te ata pashë një seri të programeve të Ramazanit, ku fliteshte për nderin, e atje e pashë këtë adresë. U befasova. Ky program më flet mua. Andaj ju drejtova juve që t'ju pyes: A ka mundësi që të më pranohet All-llahu dhe a ka mundësi të kthehem te Zoti?"

Më erdhi kjo letër dhe thashë: Subhanall-llah, shpirti njerëzor sado që gjindet në fund të fundit, vazhdimisht mallëngjohet për Zotin dhe ashtu sikurse uritet barku për ushqim, ashtu shpirti i uritet për Zot.

Ia dërgova përgjigjen ku i thashë se natyrisht që All-llahu [subhanehu ve teal] ta pranon pendimin tënd dhe e udhëzova në disa kushte të pendimit.

Mua lajmërua pas dy ditëve duke më thënë:

"Jam penduar, kam lërë dashnorin tim dhe nuk do ta shoh më pas sodit".

Pastaj mu lajmërua pas dy ditëve e më tha: "Dëshiroj të mësoj të falem".

Pas dy ditëve mua lajmërua duke thënë: "Dëshiroj të kem audio kasete me lexime të Kur'anit".

I dërgova me DHL kasete me lexim të Kur'anit, prej lexuesve të ndryshëm, siç është Axhmi, Meshari Rashid, nga lexuesit e Medines dhe të gjitha kasetat e mia.

Heshti një javë. Pastaj sërish mu lajmërua duke thënë:

"Kam dhënë dorëheqje nga mis i bukurisë së qytetit".

E pas katër ditëve më befasoi duke më thënë:

"Jam mbuluar".

Mirëpo tregimi nuk përfundon këtu.

Pasiqë u mbulua, pas dy ditëve, lajmërohet dhe më tregon se ndien dhimbje të mëdha. Shkoi në mjek dhe më tregoi se mjeku i ka treguar se ka kancer në tru dhe se ditët e jetës janë të numëruara.

Kjo vajzë do të hyn në operacion në Australi të premtën e ardhshme për të bërë një ndërhyrje emergjente në tru, kurse mundësia e suksesit është 20 %, siç kishin thënë mjekët.

Këtë e kanë thënë mjekët, kurse ajo më dërgoi një letër ku thoshte atë që s'kanë mundur ta thonë as dijetarët e dalluar në adhurim:

"Unë jam shumë e gëzuar me takimin me Zotin. Jam e gëzuar që jam penduar para se ta dija se jam e sëmurë. Nuk e di se a do ta dijë babi dhe nëna ime këtë që më ka ndodhur. Ata shumë rrallë më lajmërohen, mirëpo unë jam penduar që tre javë, kurse 20 vjet kam bëtë mëkate karshi Zotit. All-llahun [subhanehu ve teal] e lus që të më bëjë nga banorët e Xhennetit, e nëse jetoj të jem në shërbim të Islamit në këtë faqe tuajën. Kjo faqe ishte dritareja ime drejt Islamit".

Komenti im: Lutjuni All-llahut së bashku me mua që ta shëron. Flasim ditën e xhuma, inshaAll-llah.

I lartësuar qoftë All-llahu, i cili i udhëzon robërit e tij, ua pranon pendimin dhe i mëshiron me mëshirën

e gjërë.

Rënkimi i mëkatarëve është më i dashur te ne se sa lavdërimi i mburravecave.

Kurse sot shkroi këtë:

In-na lilah ve inna ilejhi raxhiun. Të All-llahut jemi dhe te Ai do të kthehemi. All-llahu ynë na shpërble në këtë fatkeqësi tonën dhe na e kompenzo me diç ma të mirë. Sara 22 vjeçare vdiç dhe u varros sot te varezat e muslimanëve në Zelandën e Re. Ia falën namazin e xhenazës pas namazit të xhumasë, kurse mua më dërgoi një letër të shkurtër para operacionit, ku mes tjerash thoshte:

"Kam jetuar 22 vjet larg Zotit, mirëpo jam penduar që tre javë. Kam dëshmitar All-llahut se jam penduar dhe jam larguar nga dashnori im, nga puna në bar dhe kam lërë misbukurinë, jam mbuluar dhe falem rregullisht. Zotin e kam dëshmitar se tërë këtë e bëj vetëm për hirë të Zotit tim. Unë nuk njoh musliman përveç teje dhe përveç këtij forumi. Ju lutem, lutuni për mua që të më mëshirojë Zoti, të mi fal mëkatet. Lutuni të ma udhëzojë Zoti nënën time, sepse ajo nuk di asgjë për mua". Sara.

Ju lutem bëni çdo gjë që keni mundësi, haxhaxh, sadaka dhe lutje për Sarën. A e shihni mëshirën e Zotit ndaj robërve të vet. Zoti ka caktuar të vdes në këtë kohë, mirëpo shikoni mëshirën e Zotit, i Cili ia mundësoi pendimin dhe ikjen nga mëkatete tre javë para se të vdes.

"Në të gjitha këto ka përkujtim, për atë që ka mendje të shëndoshë, që i ka vënë veshin me vëmendje, dhe është i pranishëm". (Kaff: 37).

Marrë nga: amrkhaled.net

Përshtati: Bekir Halimi

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

Rr. Stiv Naumov 7 / 18

Tel. ++389 (02) 32 23-654

1000, Shkup



Pendimi i personit në duart e bijës së tij të vogël

Në qytetin Rijad jetonte një njeri në humbje dhe shumë pak e njihte All-llahun sss. Që nga shume vite nuk kishte hyrë në xhami dhe nuk ishte përlur për All-llahun [subhanehu ve tealal]. Por, deshi All-llahu që pendimi i tij të jetë në duart e bijës së tij të vogël!

Rrëfen tregimin dhe thotë:

„Kam qenë ai person, i cili kam ndejtur deri në mëngjes me shokë të këqij në lojëra, epshe e humbje, duke e lënë gruan time të mjerë. E ajo ankohej nga vetmia, ngushtimi dhe dhimbjet. . . All-llahu [subhanehu ve tealal] e dinë më së miri për këtë. Më humbi vullneti dhe u dobësova nga kjo grua e bukur dhe e pastërt, megjithatë ajo nuk ngurronte dhe nuk pesimizohej nga kjo duke më këshilluar për udhëzim, por pa dobi.

Një natë prej netëve, erdha nga njëra prej këtyre ndejave që bëja në to qeife dhe lojëra të ndryshme. Ora ishte tre pas mesnate. Pas kthyerjes në shtëpi gjeta gruan dhe bijën time të mbuluara në një gjumë të thellë. Hyra në dhomën e ndejës që t'i plotësoj këto orë të mbetura nga kjo natë duke i shikuar disa filma të prishur përmes videos, në ato orë kur zbret All-llahu [subhanehu ve tealal] në qiellin e dunjat dhe thotë: „A ka kush të më lutet e t'i përgjigjem? A ka kush që kërkon falje e t'ia fali atij? A ka kush që kërkon diçka e t'i jap?”

Papritmas. . . u hap dera e dhomës e kur pashë ajo ishte bija ime e vogël, e cila nuk i kishte mbushur ende të gjashtat. E shikova atë me habi dhe përbuzje e ajo më parapriu duke më thënë:

- Turp për ty o babai im, frikësoju All-llahut!

Këtë e përsëriti tre herë.

Më goditi një habi e madhe e papritur, e mbylla videon. U ula duke menduar në fjalët e saja, të cilat vazhdonin duke u përsëritur në të dëgjuarit tim gati se më mbyllën! E ndoqa pas, dhe e gjeta të shtrirë në shtratin e saj.

U bëra sikur i çmenduri, nuk e dija se çfarë më goditi dhe nuk e dija se çfarë janë këto momente përderisa u dëgjua zëri i muezinit të xhamisë së afërt, zë ky që e këputi qetësinë e natës dhe thërriste për në namaz të sabahut.

Mora abdes dhe shkova në xhami. Edhe pse nuk kisha aq vullnet të madh për namaz mirëpo, ajo që më shtyri të shkoj në xhami ishin fjalët e bijës sime të vogël. U afua namazi, thirri ikameti u lidhë imami në namaz, lexoi atë që u lehtësua nga Kur'ani ra në sexhde e unë shkoja pas tij. Vendosa ballin i përlur para All-llahut [subhanehu ve tealal] përderisa më rrodhën lotët e nuk e dija shkaku e rrjedhjes së tyre. Kjo ishte sexhdja e parë që e bëja për All-llahun [subhanehu ve tealal] që prej gjashtë viteve. Ishte kjo qarje e dobishme për mua sa që më të doli gjithë ajo çka kisha në zemër prej mosbesimit, dyfyturësisë dhe mëkateve.

E hetova se kjo thirrje për namaz filloi të mi lehtësoj dhe të mi çelë punët në

Sh.Q. "Klubi Studentor"

mbrendësinë time. Pas namazit u ula në xhami një kohë të shkurtër pastaj u ktheva tek bija ime. Rash të pushoj, por nuk e shijova ushqimin e gjumit, vazhdova në këtë gjendje deri sa shkova tek shefi im i punës. U habit me prezencën time të hershme gjë që nuk ngjante herave tjera, për shkak të ndejave gjatë tërë natës. Më pyeti për shkaku e prezencës së hershme e i tregova se çfarë më kishte ndodhur mbrëmë.

Falënderoj All-llahun, i Cili të ka dhuruar këtë vajzë të vogël e nuk të ka ardhur engjulli i vdekjes që ta merr shpirtin në këtë gjendje- më tha shefi i punës.

U afua koha e namazit të drekës isha i lodhur, për atë se nuk kisha fjetur që një kohë të gjatë. Kërkova nga shefi im të më liron nga puna. U ktheva në shtëpi të pushoj. Me këtë kthyerje në shtëpi ishte edhe dëshira e madhe për ta parë bijën time të vogël, e cila ishte shkak për udhëzimin tim dhe kthyerjen time te All-llahu [subhanehu ve tealal].

Vazhdon rrëfyesi e thotë: U ktheva në shtëpi dhe e gjeta gruan time të ndalur para derës së shtëpisë, jo në mënyrë të zakonshme sikurse herave tjera. Bërtiti dhe më tha:

- Ku ishe?

-Në punë!- i thashë.

- Të kërkuam në telefon por nuk të gjetëm, më trego ku ishe?-ma priti.

- Isha në xhaminë, e cila është afër vendit të punës. . . çfarë ka ndodhur dhe ç'të ka shtyer të qëndrosh para derës së shtëpisë në këtë orë?-e pyeta.

- Ka vdekur bija yte!-më tronditi.

Nuk munda të mbahem nga ky lajm tmerrues dhe fillova të qaja. Nuk kujtoja tjetër përveç fjalët e saja: "Turp për ty o babai im, frikësoju All-llahut, turp për ty o babai im, frikësoju All-llahut!"

Vazhdon rrëfyesi e thotë: "Thirra në punë dhe e njoftova shefin tim për vdekjen e bijës sime të vogël, të cilën e bëri All-llahu [subhanehu ve tealal] shkak për daljen time nga errësira në dritë. Erdhi shefi im duke shpejtuar. Hyra mbrenda e pastrova dhe e përgatita bijën time për ta varrosur. Shkuam në xhami për t'ia falur namazin, pastaj u nisëm për në varrezat. Më tha shefi i punës:

- Merre bijën tënde dhe vendose nën dhe. E mora bijën time të vogël dhe u drejtova nga njerëzit që ishin rreth meje:

-Pasha All-llahun, nuk po e varrosi bijën time, por po e vorrosi dritën e cila ma ndriçoi rrugën për tu kthyer të All-llahu [subhanehu ve tealal]. Këtë vajzë e bëri All-llahu shkak për udhëzim. E lus All-llahun [subhanehu ve tealal] të më bashkoi me të në Xhennetin e Tij. Filluan njerëzit përreth meje të qajnë, gati sa zemrat e tyre rënktonin nga pikëllimi për vdekjen e bijës sime të vogël, e cila nuk i kishte mbushur të gjashtat!"

Kështu pra vëllëzër të dashur, nuk e din njeriu se ku e zë engjulli i vdekjes. Vdekja nuk njih të vogël e as të madh. All-llahu [subhanehu ve tealal] thotë: "E kur të vijë afati i tyre, për asnjë moment nuk mund ta vonojnë e as ta ngusin" (En-Nahl: 61).

Le t'i shpejtojme hapat për arritje sa më të shpejtë tek All-llahu [subhanehu ve tealal] e të paralajmërojmë me pendim të sinqertë me shpresë që ky pendim të jetë momenti i fundit i jetës sonë dhe të jetë shpërblimi ynë në xhennetin e Mëshiruesit.

Mahmud El-Misrij

Përktheu: Lulzim Murseli

Vdekja pas një pendimi

